



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 27/08

Prishtinë, më 28.10.2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Naser Osmani, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Gani Koci, Safete Hadërgjonaj, Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Afrim Lajqi, Ramiz Krasniqi nga ZRRUM, Emma Kellne, Judita Albrecht, Aunethe Kouge nga GTZ, Serafim Ahmedov, Fatmir Uka nga ZAGJ, Tek Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, NDI, KDI, AUK, Visar Predreza nga “Kosova Sot”.

Kryesues: Haki Shatri, Zëvendëskryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues lidhur me kërkesën buxhetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009**
- 3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues lidhur me kërkesën buxhetore të Zyra së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2009**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3192 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore nr. 400-417-08 të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2009**

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrë së Auditorit Gjeneral për vitin 2009

7. Të ndryshme.

Kryesuesi, përshëndeti anëtarin e ri z. Riza Smaka, i cili ka zëvendësuar z. Behxhet Pacolli nga parti AKR. Kryesuesi njoftoi anëtarët me projektin që ka të bëjë me mbështetjen e punës së Komisionit e i cili do të implementohet nga GTZ. Për më tepër lidhur me këtë projekt do të diskutohet në një takim të organizuar të enjten në Universitetin Amerikan. Përshëndeti përfaqësuesit e GTZ për praninë e tyre.

Judita Albrecht, njoftoi se ky projekt është pjesë e marrëveshjes së arritur në mes Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Kosovës. Qëllimi i tij është mbështetje e KBF, ofrimi i ekspertëve për ofrimin e këshillave ligjore dhe teknike. Përveç dhënies së ndihmës së komisionit në çështjet buxhetore, projekti ka për qëllim edhe ofrimin e ndihmës për buxhetin e agjencioneve të pavarura. Projekti do të fillojë në Janar 2009 dhe parashikohet të zgjat tre vite. Shuma e projektit do të jetë 2.5 milion euro.

Besa Gaxherri, falënderoi GTZ për ofrimin e këtij donacioni. Pyeti se kjo shumë a është pjesë e shumës së ofruar nga Gjermania në konferencën e donatorëve apo ndihmë e veçantë.

Judita Albrecht, duke i'u përgjigjur z. Gaxherri, theksoi se është pjesë e shumës së ofruar prej 100 milion eurosh në konferencën e donatorëve nga Gjermania për Kosovën.

Naser Osmani, propozoi që në mbledhjen e radhës së Komisionit të diskutohet për gjendjen e trustit të Kursimeve Pensionale në Kosovë

Kryesuesi, propozimin e z. Osmani e konsideroi si të qëlluar dhe u pajtua që kjo të jetë çështje e veçantë diskutimi për në mbledhjen e radhës.

Më pas konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues lidhur me kërkesën buxhetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009

Kryesuesi, kërkoi nga grupi punues të prezantoi rekomandimet lidhur me modifikimin e kërkesës buxhetore të KPMM-së.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se pas vështërsive që ka pasur, kanë arritur të bëjnë modifikimin e kërkesës së këtij agjencioni në disa kategori. Në kategorinë paga dhe meditje nuk ka ndryshime, përveç se është zvogëluar numri i punëtorëve të paraparë dhe shuma totale ka mbetur 308.405 euro. Në kategorinë mallra dhe shërbime kanë mbetur 616, 648 euro. Ndërsa në kategorinë shpenzime kapitale është hequr një pozicion në vlerë prej 160,000. Shuma totale e zbritjeve arrin vlerën 212,275 euro. Z. Demaliaj tha se nëse merret një vendim qartësuar për paga dhe meditje për të gjitha agjencionet e pavarura, atëherë edhe ky agjencion do të hynë në këtë kategori.

Haki Shatri, theksoi se aktivitetet e agjencionit do të jenë më të gjëra, përmendi angazhimin në punë të laboratorit. Pyeti anëtarët e grupit punues se a mendojnë se me këto ndryshim në buxhet, KPMM-ja do të mund të realizojnë aktivitetet e parapara për vitin 2009.

Shkumbin Demaliaj, e kanë marrë miratimin e përfaqësuesve të agjencionit në fjalë se edhe me ndryshimet e bëra mund të i realizojnë qëllimet.

Hajdin Abazi, kërkoi mendimin dhe sqarimin e drejtorit të buxhetit z. Krasniqi.

Agim Krasniqi, theksoi se rritje janë bërë edhe me ndryshimet e fundit. 70 % në kategoritë operative. Kërkesat e agjencioneve do të përfshihen në kufijtë e lejuar nga MEF-i, ndërsa Qeveria për agjencionet e pavarura do të bëjë një rekomandim të veçantë me shkrim. Kërkesat e këtyre agjencioneve nuk i përshtaten rrethanave ekonomike në vend. Deri në momentin e nxjerrjes së ligjit për paga, pagat e agjencioneve mbesin ashtu siç i përcakton ky Komision dhe miraton Kuvendi.

Riza Smaka, theksoi se çështje paraprake dhe parimore është vendosja e rregullave të unifikuara që do të shërbenin si bazë për vendosjen lidhur me kërkesat e agjencioneve dhe institucioneve buxhetore. Propozoi që të bëhet një sistem të pagave në bazë të kritereve, objektivave dhe normativave të standardizuara, një sistem të drejtë dhe korrekt, që me rasti e përcaktimit të pagave duhet merret parasysh kualifikimi, përgjegjshmëria dhe aktiviteti.

Besa Gaxherri, theksoi se problemet e shfaqura janë pikërisht për shkak të mungesës së rregullatave ligjore. u pajtua me mendimet që të gjitha agjencionet të përfshihen në kornizat e buxhetit. Por se paraprakisht të analizohen kërkesat e tyre, të gjitha kategoritë buxhetore dhe të bëhet nivelizimi i pagave të tyre. Parasegjithash një zgjidhje të këtyre duhet bërë me agjencionet që i ka themeluar Kuvendi dhe i japin përgjegjësi atij.

Haki Shatri, kjo fazë e trajtimit të kërkesave të agjencioneve buxhetore konsiderohet si periudhë e dëgjimeve buxhetore. Më trajtimin e buxhetit të agjencioneve dhe institucioneve buxhetore do të me rastin e shqyrtimit të buxhetit të përgjithshëm. Konsiderojë si punë të mirë të nëngrupit.

Shkumbin Demaliaj, u pajtua me idenë që të bëhet nivelizimi i pagave për të gjitha agjencioneve që i ka themeluar Kuvendi. Kërkoi që të janë përgjegjës për të nxjerr disa konkluzione që janë të pranueshme.

Haki Shatri, u pajtua me idenë për nivelizimi të pagave. Bordet të trajtohen njësoj, ashtu sikurse edhe stafi civil. Kjo çështje pritet të rregullohet me udhëzimin administrativ që është në procedurë të nxjerrjes nga Qeveria.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni mbështet kërkesën buxhetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2009 me ndryshimet e bëra në kategoritë e caktuara ekonomike dhe i propozon MEF-it që kërkesën e tillë ta radhis në kornizat e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës për vitin 2009.
- II. Buxheti i KPMM-së do të shqyrtohet dhe miratohet gjatë procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit për vitin 2009 në Kuvendin e Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve të grupit punues lidhur me kërkesën buxhetore të Zyra së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2009

Kryesuesi, njoftoi për takimin që ka zhvilluar grupi punues me përfaqësuesit e ZRRUM-së dhe shfaqjen e mospajtimeve lidhur me kërkesën e tyre. Duke shfrytëzuar praninë e tyre pyeti nëse kanë bërë ndonjë ndryshim në kategoritë e caktuara.

Afrim Lajqi, njoftoi se pas takimeve që kanë pasur me anëtarët e grupit punues, kanë përfillur rekomandimet e tyre dhe kanë bërë reduktime në dy kategori, paga dhe meditje dhe mallra (prej 224.250 janë zbritur në 143.101 euro) dhe shërbime (nga 227.800 në 184.300 euro). Kërkoj që me rastin e harmonizimit të pagave, ky agjencion të trajtohet në mënyrë të barabartë ,me agjencionet tjera relevante (ZRRE, ART).

Riza Smaka, nga trajtimi i këtyre kërkesave shifet se kemi të bëjmë me një arbitrazh, mungojnë rregullat dhe ekziston një laramani. Kërkoj që ky Komision t'i bëjë një propozim Qeverisë për nxjerrjen e Ligjit për paga, me anë të të cilit do të rregulloheshin këto çështje. Në këtë mënyrë do të krijoheshin kriteriumet edhe për votim.

Kryesuesi, duke i'u përgjigjur vërejtjeve të parafolësit, theksoi se problemi i shfaqur me këto agjencione të pavarura është si rezultat i asaj se këto kanë qenë fuqi e rezervuar e PSSP-së. Njoftoi se Qeveria së bashku me MSHP-në, ka nxjerr një udhëzim administrativ (i cili ende nuk është zyrtarizuar) me të cilin rregullohet çështja e pagave për të gjithë ata që marrin paga të tilla nga buxheti i Kosovës, prej të zgjedhur deri të shërbyesit civil.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- III. Komisioni mbështet kërkesën buxhetore të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2009 me ndryshimet e bëra dhe i propozon MEF-it që kërkesën e tillë ta radhis në kornizat e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës.
- IV. Buxheti i ZRRUM-së do të shqyrtohet dhe miratohet gjatë procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit për vitin 2009 në Kuvendin e Kosovës.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3192 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave

Kryesuesi, njoftoi se kemi të bëjmë me kërkesën që është shqyrtuar më herët nga Komisioni, por se është kthyer mbrapa për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë (CV) për kandidatët e propozuar. Tani shifet se këto dokumente janë plotësuar dhe kërkoj që t'i propozohet Kryesisë që të radhis për diskutim në seancë plenare.

Kosara Nikolic, u ankua se materialin nuk e ka marrë në gjuhën serbe.

Besa Gaxherri, kërkoi që CV e tilla të mos vijnë në komision vetëm në gjuhën angleze, por në gjuhët zyrtare.

Kryesuesi, theksoi se znj. Nikolic ka të drejtë, kërkoi që kjo pikë ë shtyhet për votim për mbledhjen e radhës për shkak të mungesës së materialit në versionin serbisht.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Pika e katërt e rendit të ditës shtyhet për mbledhje e radhës së Komisionit. Kërkohet që materiali të dërgohet edhe në gjuhën serbe në mënyrë që të mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore nr. 400-417-08 të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2009

Kryesuesi, njoftoi se kemi të bëjmë me një ankesë të KQZ-së me të cilën shfaqen pakënaqësitë lidhur me miratimin e kërkesës së tyre nga MEF-i. Konsideroi se kjo kërkesë nuk duhej të jetë objekt trajtimi në këtë mbledhje, por se ajo do të mund të shqyrtohej me rastin e shqyrtimit të buxhetit të përgjithshëm.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni i sugjeron KQZ-së të dorëzon kërkesën buxhetore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që kërkesën e tillë të përshijë në kornizat e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës.
- II. Një kërkesë e këtillë do të mund të ishte objekt trajtimi nga Komisioni me rastin e shqyrtimit të buxhetit të agjencioneve buxhetore që janë të përfshira në kuadër të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës.

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrë së Auditorit Gjeneral për vitin 2009

Kryesuesi, kërkoi nga përfaqësuesit e ZAGJ-së sqarime për përsëritjen e kërkesës, kur dihet se kërkesa e tillë është miratuar nga Komisioni.

Serafim Ahmedov, falënderoi për mbështetjen e dhënë nga komisioni për ZAGJ, për sqarimin e mëtutjeshme të kërkesës i'a dha fjalën drejtorit të administratës së ZAGJ-së.

Fatmir Uka, arsyeja e përsëritjes së kërkesës ka të bëjë me faktin se rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën buxhetore të ZAGJ-së nuk është përfillur nga MEF-i dhe buxhetin ynë ka mbetur ashtu siq kanë vendosur ata më herët.

Naser Osmani, kërkoi që si deputet të përqendrohen në agjencionet që i ka themeluar Kuvendi. Ndaj agjencioneve siç është Zyra e Auditorit Gjeneral, Agjencioni Anti Korrupsion, Zyra e Prokurimit Publik duhet të jemi të vëmendshëm. Në Zyrën e Auditorit janë krijuar marrëdhëniet ndërnjerëzore jo të mira. Qeveria ka ndërhyrë në punën e tij. Kjo ka të bëjë edhe me financimin e këtij agjencioni. U shpreh i brengosur me situatën e krijuar dhe kërkoi që ky agjencion të jetë i pavarur, t'i përgjigjet Kuvendit dhe të jenë të suksesshme në punën e tij.

Kryesuesi, u pajtua me mendimin të gjitha agjencionet duet të jenë të pavarura në aspektin e vendimmarrjes nga institucioni që i financon ato.

Myrvete Pantina, duke ditur rëndësinë që ka Komisioni në mbikëqyerjen e mjeteve të buxhetit, theksoi se duhet insistuar që rekomandimet e këtij Komisioni të respektohen .

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohet kërkesa buxhetore nr. 431 dt. 17 tetor 2008 e Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2009 dhe i rekomandohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financa që kërkesën e tillë ta përfshijë në kornizat e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës.

7. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi me disa kërkesa që kanë ardhur pas shpërndarjes së rendit të ditës dhe materialeve përkatës. Një kërkesë e këtillë është e AAK, për të cilën komisioni e ka dhënë rekomandimin e vet, andaj nuk nevojë që të diskutohet për atë.

Kërkesa tjetër ka të bëjë më Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Duke ditur se kemi miratuar buxhetin e tyre, një propozim të tillë mund të jetë objekt trajtimi me rastin e shqyrtimit të buxhetit të përgjithshëm.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Komisioni ka miratuar buxhetin e KPMS-së, në kuadër të buxhetit të Kuvendit. Çdo kërkesë e këtij Këshilli që ka të bëjë me buxhetin e vitit 2009, do të mund të ishte objekt trajtimi me rastin e shqyrtimit të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 14:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Haki SHATRI